

VENDIM
Nr. 97, datë 23.4.2018

MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA
SHOQËRIA ALBGAZ SHA,
PËR VITIN 2018

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 13, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 19 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çmimeve dhe Tarifave, në lidhje me “Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2018”,

konstatoi se:

- Shoqëria ALBGAZ sh.a., me shkresën nr. 85/1 prot., datë 3.1.2018, protokolluar në ERE me nr. 13 prot., datë 4.1.2018, ka paraqitur kërkesën “Për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror”, sipas materialit që shoqëria i ka bashkangjitur kësaj kërkesë.

- ERE, me vendimin nr. 90, datë 7.6.2017, ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a., për periudhën 5.1.2017–20.9.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 155, datë 28.9.2017 dhe me vendimin nr. 14, datë 10.1.2018.

- ERE, me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, ka miratuar *Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror*.

- ERE, me vendimin e bordit nr. 20, datë 19.1.2018, vendosi “*Mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a., për vitin 2018*”.

- ERE, pas marrjes së vendimit nr. 20, datë 19.1.2018 “*Mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a., për vitin 2018*”, ka vijuar me dërgimin e këtij vendimi për publikim në mediat e shkruara kombëtare, si dhe në faqen e saj të internetit dhe palëve të interesuara për marrje mendimi. Në përfundim ka rezultuar se asnjë palë nuk ka shprehur opinionin/komente në lidhje me këtë aplikim.

- ERE, me anë të shkresës 13/1 prot., datë 26.1.2018, pas analizës së kryer këtij aplikimi i kërkoi nga shoqëria ALBGAZ sh.a. dokumentacion plotësues lidhur me çështjet e argumentuara në këtë kërkesë.

- Shoqëria ALBGAZ sh.a., me anë të shkresës nr. 13/3 prot., datë 20.2.2018, ktheu përgjigje në lidhje me kërkesat për informacion nga ana e Entit Rregullator të Energjisë.

- ERE, pas analizës së përgjigjeve të dërguara nga shoqëria, në datën 20.3.2018, organizoi një seancë dëgjimore teknike me përfaqësuesit e ALBGAZ sh.a. dhe Albpetrol sh.a. Në seancën dëgjimore teknike u diskutuan çështjet e paqartësuara, në lidhje me analizën e kryer të aplikimit në vetvete, përgjigjeve shtesë të dërguara nga shoqëria, si dhe trajtimet teorike të metodologjisë përkatëse për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror. Në përfundim të seancës, u ra dakord që të dërgoheshin në ERE sqarime të mëtejshme për komponentët e ndryshëm të të ardhurave të kërkuara për tarifën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2018.

- ERE, në datën 30.3.2018, organizoi një tjetër seancë dëgjimore për të gjitha palët e interesuara në këtë proces, pas dërgimit të shpjegimeve shtesë mbi aplikimin për tarifën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2018, nga ana e shoqërisë ALBGAZ sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a., për vitin 2018 prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kwh.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit

të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti